REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.15, datë 23/05/2005

"MBI DISA NDRYSHIME NE V.K.B Nr.51, Dt.03/11/2004 "PËR DELEGIMIN E DISA KOMPETENCAVE NJËSIVE BASHKIAKE TË QYTETIT TË TIRANËS, V.K.B Nr.10, Dt.21/03/2005 "MBI DISA NDRYSHIME NË V.K.B NR.18, DT.26/01/2001 "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË NJËSIVE BASHKIAKE TË TIRANËS", V.K.B Nr.12, Dt.21/03/2005 "PËR MIRATIMIN E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË VITI 2004 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2005", V.K.B Nr.13, Dt.21/03/2005 "PËR KALIMIN KAPITAL TË OBJEKTEVE DHE MJETEVE JO KRYESORE DHE DHËNIEN NË PËRDORIM DHE ADMINISTRIM TË BIBLIOTEKAVE, NJËSIVE BASHKIAKE TË QYTETIT TË TIRANËS".

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 19, pika 1-8 dhe neni 32, gërma ç, dh, e, ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 "Për buxhetin lokal", neni 18 dhe neni 21, ndryshuar me ligjin Nr. 8399, dt.09/09/1998, ligjit Nr.8654, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.51, dt.03/11/2004, Vendimeve të Këshillit Bashkiak Nr.10, Nr.12, Nr.13, dt.21/03/2005, bazuar në kërkesën e Njësisë Bashkiake Nr.3 me Nr.1697/1 Prot, dt.08/04/2005 dhe të Njësisë Bashkiake Nr.4 me Nr.3604/1 Prot, dt.05/04/2005, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë një ndryshim në pikën 3 të V.K.B Nr.51, dt.03/11/2004.

2. Në mbështetje të pikës 1 të këtij Vendimi, Biblioteka Nr.10 kalon në varësi të Njësisë Bashkiake Nr.4.

3. Të miratojë një ndryshim në pikën 1 të V.K.B Nr.10, dt.21/03/2005, sipas Tabelës Nr.1 bashkëlidhur.

4. Të miratojë një ndryshim në pikën 1 të V.K.B Nr.13, dt.21/03/2005, sipas pasqyrës së kalimeve kapitale bashkëlidhur.

5. Të miratojë një ndryshim në pikën 3 të V.K.B Nr. 13, dt.21/03/2005, sipas listës bashkëlidhur.

6. Të miratojë një ndryshim në pikën 2 të V.K.B Nr. 12, dt.21/03/2005, pasqyra 3/1 “Plani i buxhetit nga transferta e pakushtëzuar” për funksionin e administratës vendore sipas pasqyrës bashkëlidhur.

7. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Njësia Bashkiake Nr.3 dhe Njësia Bashkiake Nr.4.

8. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI